VENDIM
Nr.1078, datë 29.12.2010

PËR AUTORIZIMIN E KURUM INTERNATIONAL, SHA PËR IMPORTIN E MBRETJEVE METALIKE TË HEKURIT DHE ÇELIKUT, PËR QËLLIME RICIKLIMI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3 të nenit 22 të ligjit nr.8934, datë 5.9.2002 "Për mbrojtjen e mjedisit", të ndryshuar, dhe të nenit 26 të ligjit nr.9010, datë 13.2.2003 "Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autorizimin e Kurum International, sh.a., për importin e mbetjeve metalike të hekurit dhe çelikut, me kodin GA 720410, 720429, 720430, 720441, 720449 dhe B1-B1010, të Konventës së Bazelit, anekset 1 e 2 "Mbetjet e listës së gjelbër", referuar vendimit nr.825, datë 13.10.2010 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listave të mbetjeve që lejohen të importohen, për qëllime përdorimi, riciklimi dhe përpunimi", për qëllime riciklimi, si më poshtë vijon:

- GA 720410 mbetje dhe kthime të gizës së derdhur;
- GA 720429 mbetje dhe kthime të çeliqeve të lidhur;
- GA 720430 mbetje dhe kthime të gizës dhe çelikut të kallajisur;
- GA 720441 copa të vogla, ashkla, feta, mbetje, bluajtje, pluhur sharrimi, pluhur lëmimi, mbetje nga zbukurimet dhe stampimet, nëse janë apo jo në tufë;
- GA 720449 mbetje të fragmentizuara, ashkla.

2. Sasia e mbetjeve metalike të hekurit dhe çelikut, që importohet sipas kodeve të referuara në pikën 1 të këtij vendimi, është 300 000 (treqind mijë) tonë.

3. Mbetjet importohen nga shteti i Serbisë, duke kaluar transit nëpërmjet shtetit të Malit të Zi. Transporti bëhet në rrugë tokësore, duke plotësuar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm ligjor për transportin ndërkombëtar të mbetjeve, si dhe kërkesat e kreut II të vendimit nr.806, datë 4.12.2003 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullave dhe procedurave për importimin e mbetjeve për përdorim, përpunim dhe riciklim".

4. Periudha e lejimit të importit të mbetjeve metalike të hekurit dhe çelikut nga Kurum International, sh.a. është nga data 1.1.2011 deri më 1.12.2011.

5. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, në zbatim të kërkesave të mësipërme ligjore, merr masat e nevojshme për kontrollin e procesit të riciklimit të mbetjeve metalike të hekurit dhe çelikut, nga Kurum International, sh.a., pas miratimit të këtij vendimi, për të siguruar mbrojtjen e mjedisit dhe të shëndetit të njeriut.

6. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave komunikon, me shkrim, me shtetet eksportuese dhe ato të kalimit transit të kësaj sasie të mbetjeve metalike të hekurit dhe çelikut, në përmbushje të kërkesave të konventës së Bazelit "Për kontrollin e lëvizjeve ndërkufitare të mbetjeve të rrezikshme dhe asgjësimin e tyre", në të cilën Republika e Shqipërisë është palë.

7. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha